

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“FA Group” SH.P.K.

Sot në Tiranë, më datën 07.01.2025 me cilësinë e Ortakut të Vetëm të shoqërisë:

FATOS MUSTAFA lindur më 27.05.1976 në Maqedoninë e Veriut dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H60527205I me cilësinë e Ortakut të Vetëm, harton këtë akt themelimi të Shoqërisë Tregtare **“FA Group” SH.P.K.**

Me nënshkrimin e këtij Akti Themelimi të shoqërisë tregtare, nënshkruesi dhe themeluesi i saj merr përsipër të realizojë e të respektojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga klauzolat e mëposhtme, të cilat do të specifikohen gjerësisht në Statutin e shoqërisë:

THEMELIMI I SHOQËRISË

Në mbështetje dhe zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar si dhe ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", i ndryshuar themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar **“FA Group” sh.p.k.** (më poshtë në këtë akt e quajtur "Shoqëria") nga Ortaku i Vetëm i saj.

FORMA E SHOQËRISË

Shoqëria **“FA Group” SH.P.K.** më poshtë e referuar si "Shoqëria", është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar krijuar në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, dhe rregullohet prej këtij ligji, dhe statutit të shoqërisë si dhe prej çdo dispozite tjetër ligjore të aplikueshme.



II. EMRI I SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

NENI 1

EMRI

Emri i shoqërisë është “FA Group” SH.P.K. Në çdo dokument, faturë, reklamë dhe publikime emri i shoqërisë do të pasohet nga:

- (i) fjala “me përgjegjësi të kufizuar” apo “sh.p.k”
- (ii) numri i saj i regjistrimit
- (iii) selia

NENI 2

SELIA

Selia e shoqërisë do të jetë në Rr. ”Mine Peza”, Qendra”Donika”,
Kulla A, Ap. 24, Njësia Administrative Nr. 9, Kodi Postar 1057, Tiranë.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është për një periudhë kohe të pacaktuar, duke filluar prej momentit të regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

III OBJEKTI I SHOQËRISË

NENI 4

OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar do të jetë:

1. *Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në fushën e Eksport-import, tregti me shumicë dhe pakicë të produkteve të ndryshme ushqimore dhe jo ushqimore, si dhe cdo produkt tjetër pa kufizim. Shitje duty-free.*

2. *Konsulencë për zhvillim biznesi, kërkime, analiza dhe studime tregu, ndërmjetësim, konsulence ekonomike për menjanimin e riskut ne biznes, hartime plan biznesi.*
3. *Shërbime në fushën e real-estate, marketing, ideim dhe menaxhim projektesh, shërbime në fushën e energjisë, ideim dhe organizim eventesh, shërbime juridike dhe financiare.*

Përveç veprimtarisë së parashikuara më lart, Shoqëria ka të drejtë:

1. *Të kryejë çdo aktivitet tregtar, në Shqipëri ose jashtë territorit, të lidhur me objektin e veprimtarisë.*
2. *Të lidhë çfarëdo lloj kontrate ose marrëveshje me persona fizikë shqiptarë ose të huaj, entitete private ose publike, përfshirë shoqëri tregtare dhe institucione shtetërore;*
3. *Të themelojë të gjithë llojet e shoqërive ose të marrë pjesë në shoqëri shqiptare ose të huaja apo në bashkime shoqërishe/joint venture ose në lloje të ndryshme biznesesh;*
4. *Të themelojë degë ose agjensi në Shqipëri ose jashtë territorit shqiptar;*
5. *Të japin ose të marrin hua dhe garanci;*
6. *Të ndërmarrë çfarëdo aktiviteti të lidhur, tregtar ose të një lloji tjetër dhe të procedojë me çdo veprim ligjor ose transaksion, drejtpërdrejt ose indirekt të lidhur me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë, ose që kontribuon drejtpërdrejtë ose indirekt në përmbushjen e qëllimit të Shoqërisë. Shoqëria mund të realizojë në mënyrë dytësore dhe në çdo rast vetëm me qëllim përmbushjen e qëllimit të aktivitetit të Shoqërisë, çdo aktivitet plotësues ose të lidhur apo aktivitet ose transaksion tregtar, industrial apo financiar në lidhje me pasuritë e luajtshme apo të paluajtshme që mund të konsiderohet i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e objektit të Shoqërisë.*

Në veprimtarinë e shoqërisë do të hyjë çdo veprimtari që do të konsiderohet nga ortaku si e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektit të shoqërisë dhe që nuk vjen në kundërshtim me Ligjin shqiptar.

IV KAPITALI THEMELTAR DHE ORGANIZIMI

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR



Kapitali themeltar i shoqërisë është përcaktuar në shumën 100,000 (njëqind mijë) lekë.

Kapitali themeltar është i ndarë në 1 kuotë me një vlerë nominale si më poshtë:

Z. FATOS MUSTAFA - 1 KUOTË ME VLERË 100.000 LEKË

OSE E SHPREHUR NË PËRQINDJE:

Z. FATOS MUSTAFA - 100 %

NENI 6

ORGANIZIMI

Shoqëria do të drejtohet nga një Administrator. Këtë detyrë do ta kryej për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh, **Z. FATOS MUSTAFA**, i cili do të ushtrojë të gjitha kompetencat për administrimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë, për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, me përfjashtim të kompetencave që ligji ose Statuti ia jep shprehimisht Ortakut të Vetëm.

ORTAKU I VETËM

“FA Group” SH.P.K.

FATOS MUSTAFA

FATOS MUSTAFA
